




PRISHTINË, TETOR 2020

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA NË UNIVERSITETET PUBLIKE TË KOSOVËS

2

(Mos)informimi i publikut



TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA NË UNIVERSITETET PUBLIKE TË KOSOVËS

(Mos)informimi i publikut

Publikues:

ORCA - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

www.orca-ks.org

info@orca-ks.org

Simon Shiroka, H-11, Nr. 8

Pristina, 10000, Kosova

Autore:

Liridona Ademaj

Hulumtues:

Skord Retkoceri

Dizajni:

Envinion



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë
gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë.
Falna durimin të thellojmë një punë përpara
se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një
ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo
vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu!
Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga
shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e
shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje.....	9
Gjetjet kryesore	10
Pasqyrë e transparencës formale të universiteteve publike....	12
Universiteti i Prishtinës.....	14
Universiteti i Pejës.....	15
Universiteti i Mitrovicës.....	16
Universiteti i Prizrenit	17
Universiteti i Gjilanit.....	18
Universiteti i Gjakovës	19
Universiteti i Ferizajt	21

LISTË E SHKURTESAVE

UP	Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
UHZ	Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”
UPZ	Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”
UGJFA	Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”
UMIB	Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”
UKZ	Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”
USHAF	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj
ORCA	Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

HYRJE

Transparenca formale është hapi i parë drejt transparencës së mirëfilltë dhe llogaridhënies së institucioneve publike, të cilat burim të vetëm të të ardhurave e kanë buxhetin e shtetit.

Me transparencë formale në këtë dokument, kuptohet ofrimi i qasjes formale në informacion nga ana e universiteteve publike për publikun përmes faqeve elektronike të tyre.

ORCA në këtë hulumtim ka grumbulluar të dhëna mbi ekzistencën e njëzet e shtatë (27) dokumenteve dhe informatave nga shtatë universitetet publike (Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Pejës, Universiteti i Prizrenit, Universiteti i Gjakovës, Universiteti i Mitrovicës, Universiteti i Gjilanit, dhe Universiteti i Ferizajt), të cilat përbëjnë informacionin më bazik rreth funksionimit të tyre.

Të dhënat janë grumbulluar në shtator të vitit 2020 nga ueb faqet zyrtare të shtatë universiteteve publike në vendin tonë.

Të njëjtin hulumtim, ORCA e ka kryer edhe tri herë të tjera, në shkurt të vitit 2019¹, në shtator të vitit 2019² dhe në janar të vitit 2020³.

Sipas të dhënave të grumbulluara në këtë raport, mund të shihet se tashmë ka përmirësime sa i përket publikimit të rregulloreve, vendimeve dhe informatave të nevojshme për publikun në përgjithësi.

1 Raporti "Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim", shkurt 2019, linku:www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/Transparenca-formale-e-Universiteteve-publike.pdf

2 Raporti "Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim-afati i shtatorit", shtator 2019, linku:www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Monitorimi-i-universiteteve-publike-Afati-i-Shtatorit-2019.pdf

3 Raporti "Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut, janar 2020, linku:<http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/02-Transparenca-n%C3%AB-Universitetet-Publike-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-ALB-02.pdf>

GJETJET KRYESORE

Të gjeturat e hulumtimit për këtë raport, tregojnë se katërmbëdhjetë (14) prej njëzet e shtatë (27) dokumenteve apo informatave të listuara nga ORCA, janë të publikuara nga të gjitha universitetet publike: *Statuti i universitetit, Plani Strategjik, Kodi i Etikës, Rregullorja Disiplinore, Rregullorja për Zgjedhjet Studentore, Përbërja e Parlamentit Studentor, Përbërja e Senatit, Përbërja e Rektoratit, Përbërja e Këshillit Drejtues, Rregullorja për Studimet BA, Rregullorja për Studimet MA, Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë, Planprogramet dhe Informatat për Bursa/Punësim.*

Dokumentin të cilin nuk e kanë asnjë nga pesë universitetet publike me përjashtim të Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit të Pejës është Rregullorja për studimet e doktoratës (PhD).

Meqenëse ORCA ka listuar gjithsej 27 dokumente/informata bazike të cilat përbëjnë informacionin më bazik rreth funksionimit të universiteteve publike, në të kaluarën kur janë publikuar raporte të ngjashme, disa prej universiteteve publike janë ankuar lidhur me objektivitetin e raportimeve dhe gabimin e mundshëm metodologjik nga ana e ORCA-s, pasi ato kanë arsyetuar mungesën e rregulloreve për doktoratë me faktin se ato nuk kanë programe të tilla.

ORCA thekson se sipas Ligjit për Arsimin e Lartë në Kosovë⁴, një institucion i arsimit të lartë, për të qenë universitet duhet të ketë pesë programe për studime të doktoratës në pesë fusha të ndryshme studimi.

Ndërkohë që dokumentet që u mungojnë tri prej shtatë universiteteve publike janë Buxheti (Universiteti i Prizrenit, Universiteti i Gjilanit dhe Universiteti i Ferizajt) dhe Rregullorja për SEMS (Universiteti i Pejës, Universiteti i Gjilanit dhe Universiteti i Mitrovicës).

Kurse dokumentet që u mungojnë dy prej shtatë universiteteve publike janë Raporti student/mësimdhënës (Universiteti i Prizrenit dhe Universiteti i Gjilanit), Rregullorja për bashkëpunëtorë (Universiteti i Gjakovës dhe Universiteti i Ferizajt), Vendimet e Këshillit

⁴ Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë, 2011, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761>

Drejtues (Universiteti i Gjilanit dhe Universiteti i Ferizajt), si dhe Vendimet e Rektorit (Universiteti i Prizrenit dhe Universiteti i Ferizajt).

Ndryshe nga raporti i kaluar kur vetëm tri universitete publike (Universiteti i Pejës, Mitrovicës dhe Gjakovës) kishin publikuar të dhëna rreth shpenzimeve apo buxhetit në faqet zyrtare, në këtë hulumtim është gjetur se ka pasur përmirësime rreth transparencës së shpenzimeve buxhetore meqenëse tashmë kemi katër universitete (Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Pejës, Universiteti i Gjakovës dhe Universiteti i Mitrovicës), të cilat aktualisht i kanë të publikuar këto informata përkundër që nuk janë të detajuara. Mirëpo mbeten edhe tri universitete publike (Universiteti i Prizrenit, Universiteti i Gjilanit dhe Universiteti i Ferizajt) të cilat ende nuk kanë publikuar asnjë informatë rreth buxhetit.


Universiteti i Prishtinës, mbetet universiteti më transparent meqenëse aktualisht i ka të publikuara të gjitha informatat apo dokumentet nga njëzet e shtatë (27) sa janë listuar nga ORCA. Ndërsa universiteti më pak transparent, mbetet Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, të cilit i mungojnë njëmbëdhjetë (11) dokumente apo informata.

Pasqyrë e transparencës formale të universiteteve publike


Universiteti i:	Prishtinës	Pejë	Mitrovicës	Prizrenit	Gjilanit	Gjakovës	Ferizajt
1 Raporti student/mësimdhënës	✓	✓	✓	✗	✗	✓	✓
2 Statuti i Universitetit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
3 Plani strategjik	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
4 Kodi i etikës	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
5 Rregullore disiplinore	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
6 Rregullorja për zgjedhjen e stafit akademik	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✗
7 Rregullorja për bashkëpunëtorë	✓	✓	✓	✓	✓	✗	✗
8 Buletinet	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✗
9 CV-të e stafit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✗
10 Rregullorja për të ardhurat personale	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✗
11 Buxheti	✓	✓	✓	✗	✗	✓	✗
12 Rregullorja për zgjedhjet studentore	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
13 Përbërja e Parlamentit Studentor	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
14 Përbërja e rektoratit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
15 Përbërja e Këshillit Drejtues	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
16 Përbërja e Senatit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
17 Vendimet e Senatit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✗
18 Vendimet e Këshillit Drejtues	✓	✓	✓	✓	✗	✓	✗
19 Vendimet e Rektorit	✓	✓	✓	✗	✓	✓	✗

Pasqyrë e transparencës formale të universiteteve publike

Universiteti i:	Prishtinës	Pejës	Mitrovicës	Prizrenit	Gjilanit	Gjakovës	Ferizajt
20 Vendimet e akreditimit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✗
21 Rregullorja për studimet BA	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
22 Rregullorja për studimet MA	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
23 Rregullorja për studimet PhD	✓	✓	✗	✗	✗	✗	✗
24 Rregullorja për SEMS	✓	✗	✗	✓	✗	✓	✓
25 Rregullorja për sigurimin e cilësisë	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
26 Planprogramet	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
27 Info për bursa/punësim	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Indeksi	27/27	26/27	25/27	23/27	22/27	25/27	16/27



SHKURT 2019



24



SHTATOR 2019



24



JANAR 2020



25



TETOR 2020



27

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Nga njëzet e shtatë (27) dokumente apo informacione bazike rreth funksionimit të universitetit, Universiteti i Prishtinës (UP) aktualisht i ka të publikuara të gjitha dokumentet në faqen zyrtare të tij⁵.

Në janar të këtij viti, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Prishtinës, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin dy (2) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare. Bëhet fjalë për *“Rregulloren për të ardhura personale”* dhe *“Buxhetin”*⁶.

Ndërkohë që në hulumtimin e publikuar në shkurt të vitit 2019⁷, lidhur me transparencën e Universitetit të Prishtinës, mungonin këto tri (3) informacione të nevojshme: *“Rregullorja për të ardhura personale”*, *“Buxheti”* dhe *“Përbërja e Senatit”*.

Ndërkaq më vonë në shtator të vitit 2019⁸, UP-së përsëri i mungonin tri (3) informacionet e përmendura më lartë, pra *“Rregullorja për të ardhura personale”* *“Buxheti”* dhe *“Përbërja e Senatit”*.

Në tetor të vitit 2020, Universiteti i Prishtinës i ka të publikuara edhe dy dokumente të cilat i mungonin në raportin e fundit në janar të këtij viti dhe është universiteti i vetëm publik në vendin tonë, i cili i ka të publikuara të gjitha informatat apo dokumentet e nevojshme për studentët, stafin e universitetit dhe publikun në përgjithësi.

5 Faqja zyrtare elektronike e Universitetit të Prishtinës, linku: www.uni-pr.edu/

6 Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut, janar 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/02-Transparenca-n%C3%AB-Universitetet-Publike-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-ALB-02.pdf>

7 Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim”, shkurt 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/Transparenca-formale-e-Universiteteve-publike.pdf>

8 Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim-afati i shtatorit”, shtator 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Monitorimi-i-universiteteve-publike-Afati-i-Shtatorit-2019.pdf>

UNIVERSITETI I PEJËS

Nga njëzet e shtatë (27) dokumente apo informacione bazike rreth funksionimit të universitetit, Universiteti i Pejës (UHZ) aktualisht i ka të publikuara njëzet e gjashtë (26) prej tyre në faqen zyrtare të tij⁹.

Në janar të këtij viti, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Pejës, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin katër (4) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare. Bëhet fjalë për “Raportin student/mësimdhënës”, “Vendimet e Senatit”, “Rregulloren për studimet PhD” dhe “Rregulloren për SEMS”¹⁰.

Në shkurt të vitit 2019¹¹, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Pejës, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin gjashtë (6) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare.

Në atë periudhë, UHZ nuk e kishte të publikuar “Raportin student/mësimdhënës”, “Rregulloren për zgjedhjen e stafit akademik”, “Përbërjen e Parlamentit Studentor”, “Vendimet e Senatit”, “Rregulloren për studimet PhD” dhe “Rregulloren për SEMS”.

Në hulumtimin e kryer në shtator të vitit 2019¹², UHZ i kishte publikuar “Rregulloren për zgjedhjen e stafit akademik” dhe “Përbërjen e Parlamentit Studentor”, mirëpo katër (4) dokumentet e tjera që mungonin në shkurt, ende nuk ishin publikuar. Aktualisht Universiteti i Pejës, ende nuk e ka të publikuar “Rregulloren për SEMS”. Mirëpo, UHZ është përmirësuar për tri (3) dokumente të cilat nuk i kishte të publikuara në janar të këtij viti kur edhe është hulumtuar publikimi i dokumenteve të nevojshme.

9 Faqja zyrtare elektronike e Universitetit të Pejës, linku: www.unhz.eu/

10 Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut, janar 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/02-Transparenca-n%C3%AB-Universitetet-Publike-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-ALB-02.pdf>

11 Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim”, shkurt 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/Transparenca-formale-e-Universiteteve-publike.pdf>

12 Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim-afati i shtatorit”, shtator 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Monitori-i-universiteteve-publike-Afati-i-Shtatorit-2019.pdf>


SHKURT 2019

21




SHTATOR 2019

23




JANAR 2020

23



TETOR 2020

26



SHKURT 2019



20



SHTATOR 2019



22



JANAR 2020



23



TETOR 2020



25

UNIVERSITETI I MITROVICËS

Nga njëzet e shtatë (27) dokumente apo informacione bazike rreth funksionimit të universitetit, Universiteti i Mitrovicës (UMIB) aktualisht i ka të publikuara njëzet e pesë (25) prej tyre në faqen zyrtare të tij¹³.

Në janar të këtij viti, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Mitrovicës, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin tri (3) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare. Bëhet fjalë për *“Rregulloren për bashkëpunëtorë”*, *“Rregulloren për studimet PhD”* dhe *“Rregulloren për SEMS”*¹⁴.

Në shkurt të vitit 2019¹⁵, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Mitrovicës, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti, i mungonin shtatë (7) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare. Në atë periudhë, UMIB nuk e kishte të publikuar *“Rregulloren për bashkëpunëtorë”*, *“Rregulloren për të ardhurat personale”*, *“Buxhetin”*, *“Rregulloren për zgjedhjet studentore”*, *“Vendimet e Rektorit”*, *“Rregulloren për studimet PhD”* dhe *“Rregulloren për SEMS”*.

Në shtator të vitit 2019¹⁶, Universiteti i Mitrovicës kishte publikuar *“Rregulloren për të ardhura personale”* dhe *“Rregulloren për zgjedhjet studentore”*, mirëpo pesë (5) dokumentet të tjera që mungonin në shkurt, ende nuk ishin publikuar.

Aktualisht Universiteti i Mitrovicës, ende nuk e ka të publikuar *“Rregulloren për studimet PhD”* dhe *“Rregulloren për SEMS”*. Mirëpo, UMIB është përmirësuar për dy (2) dokumente të cilat nuk i kishte të publikuara në janar të këtij viti kur edhe është hulumtuar publikimi i dokumenteve të nevojshme.

¹³ Faqja zyrtare elektronike e Universitetit të Mitrovicës, linku:www.umib.net/

¹⁴ Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut, janar 2020, linku:<http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/02-Transparenca-n%C3%AB-Universitetet-Publike-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-ALB-02.pdf>

¹⁵ Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim”, shkurt 2019, linku:<http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/Transparenca-formale-e-Universiteteve-publike.pdf>

¹⁶ Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim-afati i shtatorit”, shtator 2019, linku:<http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Monitorimi-i-universiteteve-publike-Afati-i-Shtatorit-2019.pdf>

UNIVERSITETI I PRIZRENIT

Nga njëzet e shtatë (27) dokumente apo informacione bazike rreth funksionimit të universitetit, Universiteti i Prizrenit (UPZ) aktualisht i ka të publikuara njëzet e tre (23) prej tyre në faqen zyrtare të tij¹⁷.

Në janar të këtij viti, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Prizrenit, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin katër (4) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare. Bëhet fjalë për *“Raportin student/mësimdhënës”*, *“Buxhetin”*, *“Vendimet e Rektorit”* dhe *“Rregulloren për studimet PhD”*¹⁸.

Në shkurt të vitit 2019¹⁹, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Prizrenit, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin tetë (8) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare. Në atë periudhë, UPZ nuk e kishte të publikuar *“Raportin student/mësimdhënës”*, *“Planin strategjik”*, *“Rregulloren për zgjedhjen e stafit akademik”*, *“Rregulloren për të ardhurat personale”*, *“Buxhetin”*, *“Vendimet e Rektorit”*, *“Rregulloren për studime PhD”* dhe *“Rregulloren për sigurimin e cilësisë”*.

Në shtator të vitit 2019²⁰, UPZ e kishte të publikuar *“Planin strategjik”*, *“Rregulloren për zgjedhjen e stafit akademik”*, *“Rregulloren për të ardhurat personale”* dhe *“Rregulloren për sigurimin e cilësisë”*, mirëpo katër dokumentet e tjera që mungonin në shkurt, ende nuk ishin publikuar.

Aktualisht Universiteti i Prizrenit, ende nuk e ka të publikuar *“Raportin student/mësimdhënës”*, *“Buxhetin”*, *“Vendimet e Rektorit”* dhe *“Rregulloren për studime PhD”*. Pra nuk ka pasur përmirësime në aspektin e transparencës në këtë universitet, nga hera e kaluar kur është bërë hulumtimi i publikimeve të dokumenteve të nevojshme.

17 Faqja zyrtare elektronike e Universitetit të Prizrenit, linku: www.uni-prizren.com/
18 Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut, janar 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/02-Transparenca-n%C3%AB-Universitetet-Publike-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-ALB-02.pdf>

19 Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim”, shkurt 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/Transparenca-formale-e-Universiteteve-publike.pdf>

20 Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim-afati i shtatorit”, shtator 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Monitorimi-i-universiteteve-publike-Afati-i-Shtatorit-2019.pdf>


SHKURT 2019

19




SHTATOR 2019

23




JANAR 2020

23




TETOR 2020

23




SHKURT 2019



18



SHTATOR 2019



19



JANAR 2020



20



TETOR 2020



22

UNIVERSITETI I GJILANIT

Nga njëzet e shtatë (27) dokumente apo informacione bazike rreth funksionimit të universitetit, Universiteti i Gjilanit (UKZ) aktualisht i ka të publikuara njëzet e dy (22) prej tyre në faqen zyrtare të tij²¹.

Në janar të këtij viti, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Gjilanit, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin shtatë (7) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare. Bëhet fjalë për *“Raportin student/mësimdhënës”*, *“Buxhetin”*, *“Vendimet e Rektorit”*, *“Rregulloren për studimet PhD”*, *“Vendimet e Senatit”*, *“Vendimet e Këshillit Drejtues”* dhe *“Rregulloren për SEMS”*²².

Në shkurt të vitit 2019²³, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Gjilanit, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin nëntë (9) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare.

Në atë periudhë, UKZ nuk e kishte të publikuar *“Raportin student/mësimdhënës”*, *“Rregulloren për të ardhura personale”*, *“Buxhetin”*, *“Vendimet e Senatit”*, *“Vendimet e Këshillit Drejtues”*, *“Vendimet e Rektorit”*, *“Rregulloren për studimet MA”*, *“Rregulloren për studime PhD”*, si dhe *“Rregulloren për SEMS”*.

Në shtator të vitit 2019²⁴, Universiteti i Gjilanit kishte publikuar vetëm *“Rregulloren për të ardhura personale”*, mirëpo, tetë (8) dokumentet të tjera që mungonin në shkurt, ende nuk ishin publikuar. Aktualisht Universiteti i Gjilanit ende nuk i ka të publikuara *“Raportin student/mësimdhënës”*, *“Buxhetin”*, *“Vendimet e Këshillit Drejtues”*, *“Rregulloren për studime PhD”*, si dhe *“Rregulloren për SEMS”*. Mirëpo, UKZ është përmirësuar për dy (2) dokumente të cilat nuk i kishte të publikuara në janar të këtij viti kur edhe është hulumtuar publikimi i dokumenteve të nevojshme.

²¹ Faqja zyrtare elektronike e Universitetit të Gjilanit, linku: www.uni-gjilan.net/

²² Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut, janar 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/02-Transparenca-n%C3%AB-Universitetet-Publike-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-ALB-02.pdf>

²³ Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim”, shkurt 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/Transparenca-formale-e-Universiteteve-publike.pdf>

²⁴ Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim-afati i shtatorit”, shtator 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Monitori-i-universiteteve-publike-Afati-i-Shtatorit-2019.pdf>

UNIVERSITETI I GJAKOVËS

Nga njëzet e shtatë (27) dokumente apo informacione bazike rreth funksionimit të universitetit, Universiteti i Gjakovës (UGJFA) aktualisht i ka të publikuara njëzet e pesë (25) prej tyre në faqen zyrtare të tij²⁵.

Në janar të këtij viti, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Gjakovës, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin katër (4) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare. Bëhet fjalë për *“Raportin student/mësimdhënës”*, *“Rregulloren për studimet PhD”*, *“Rregulloren për zgjedhjen e stafit akademik”* dhe *“Rregulloren për bashkëpunëtorë të jashtëm”*²⁶.

Në shkurt të vitit 2019²⁷, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Gjakovës, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin dymbëdhjetë (12) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare.

Në atë periudhë, UGJFA nuk e kishte të publikuar *“Raportin student/mësimdhënës”*, *“Planin strategjik”*, *“Rregulloren për zgjedhjen e stafit akademik”*, *“Rregulloren për bashkëpunëtorë të jashtëm”*, *“Rregulloren për të ardhura personale”*, *“Buxhetin”*, *“Përbërjen e Këshillit Drejtues”*, *“Vendimet e Senatit”*, *“Vendimet e Këshillit Drejtues”*, *“Vendimet e Rektorit”*, *“Rregulloren për studimet MA”*, si dhe *“Rregulloren për studimet PhD”*.

Ndërkaq, në shtator të vitit 2019²⁸, UGJFA kishte publikuar gjashtë (6) prej këtyre dokumenteve; *“Planin strategjik”*, *“Rregulloren për të ardhura personale”*, *“Buxhetin”*, *“Përbërjen e Këshillit Drejtues”*, *“Vendimet e Senatit”* dhe *“Vendimet e Këshillit Drejtues”*; por jo edhe informacionet rreth *“Raportit student/mësimdhënës”*, *“Rregulloren për zgjedhjen e stafit akademik”*, *“Rregulloren për bashkëpunëtorë të jashtëm”*, *“Vendimet e*


SHKURT 2019

15




SHTATOR 2019

21




JANAR 2020

23



TETOR 2020

25



²⁵ Faqja zyrtare elektronike e Universitetit të Gjakovës, linku: www.uni-gjk.org/

²⁶ Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut, janar 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/02-Transparenca-n%C3%AB-Universitetet-Publike-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-ALB-02.pdf>

²⁷ Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim”, shkurt 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/Transparenca-formale-e-Universiteteve-publike.pdf>

²⁸ Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim-afati i shtatorit”, shtator 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Monitorimi-i-universiteteve-publike-Afati-i-Shtatorit-2019.pdf>

Rektorit”, “Rregulloren për studimet MA”, si dhe “Rregulloren për studimet PhD”.

Ndërkohë janë publikuar *“Vendimet e Rektorit”, “Rregullorja për studimet MA”, “Raporti student/mësimdhënës” dhe “Rregullorja për zgjedhjen e stafit akademik”.*

Aktualisht Universiteti i Gjakovës ende nuk i ka të publikuara *“Rregulloren për bashkëpunëtorë të jashtëm”, si dhe “Rregulloren për studimet PhD”.* Mirëpo, UGJFA është përmirësuar për dy (2) dokumente të cilat nuk i kishte të publikuara në janar të këtij viti kur edhe është hulumtuar publikimi i dokumenteve të nevojshme.

UNIVERSITETI I FERIZAJT

Nga njëzet e shtatë (27) dokumente apo informacione bazike rreth funksionimit të universitetit, Universiteti i Ferizajt aktualisht i ka të publikuara vetëm gjashtëmbëdhjetë (16) prej tyre në faqen zyrtare të tij²⁹.

Në janar të këtij viti, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Ferizajt, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin nëntëmbëdhjetë (19) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare.

Bëhet fjalë për *“Raportin student/mësimdhënës”, “Planin Strategjik”, “Kodin e Etikës”, “Rregulloren disiplinore”, “Rregulloren për zgjedhjen e stafit akademik”, “Rregulloren për bashkëpunëtorë”, “Buletinet”, “CV-të e stafit”, “Rregulloren për të ardhura personale”, “Buxhetin”, “Rregulloren për zgjedhjet studentore”, “Vendimet e Rektorit”, “Vendimet e akreditimit”, “Rregulloren për studimet MA”, “Rregulloren për studimet PhD”, “Rregulloren për sigurimin e cilësisë”, “Vendimet e Senatit”, “Vendimet e Këshillit Drejtues” dhe “Rregulloren për SEMS”*³⁰.

Në shkurt të vitit 2019³¹, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Ferizajt, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin nëntëmbëdhjetë (19) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare.

Në atë periudhë, USHAF e kishte të publikuar vetëm *“Raportin student/mësimdhënës”, “Statutin e Universitetit”, “Përbërjen e Parlamentit Studentor”, “Përbërjen e Këshillit Drejtues”, “Përbërjen e Senatit”, “Rregulloren për studimet BA”, “Planprogramet” dhe “Infot për bursa/punësim”*.


SHKURT 2019

8




SHTATOR 2019

8




JANAR 2020

8



TETOR 2020

16



²⁹ Faqja zyrtare elektronike e Universitetit të Ferizajt, linku: www.ushaf.net/

³⁰ Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut, janar 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/02-Transparenca-n%C3%AB-Universitetet-Publike-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-ALB-02.pdf>

³¹ Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim”, shkurt 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/Transparenca-formale-e-Universiteteve-publike.pdf>

Në shtator të vitit 2019³², Universiteti i Ferizajt kishte publikuar vetëm *“Statutin e Universitetit”, “Përbërjen e Parlamentit Studentor”, “Përbërjen e Këshillit Drejtues”, “Përbërjen e Senatit”, “Rregulloren për studimet BA”, “Planprogramet”, “Infot për bursa/punësim” dhe “Përbërjen e Rektoratit”, si informata shtesë që nuk gjendeshin në muajin shkurt*, mirëpo nëntëmbëdhjetë (19) dokumentet e tjera ende nuk ishin publikuar.

Aktualisht Universiteti i Ferizajt ende nuk i ka të publikuara njëmbëdhjetë (11) dokumente ose informata të tjera bazike që duhet publikuar secili universitet. Bëhet fjalë për *“Rregulloren për zgjedhjen e stafit akademik”, “Rregulloren për bashkëpunëtorë”, “Buletinet”, “CV-të e stafit”, “Rregulloren për të ardhura personale”, “Buxhetin”, “Vendimet e Rektorit”, “Vendimet e Senatit”, “Vendimet e Këshillit Drejtues”, “Vendimet e akreditimit” dhe “Rregulloren për studimet PhD”*. Mirëpo, USHAF është përmirësuar për tetë (8) dokumente të cilat nuk i kishte të publikuara në janar të këtij viti kur edhe është hulumtuar publikimi i dokumenteve të nevojshme.

³² Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim-afati i shtatorit”, shtator 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Monitori-i-universiteteve-publike-Afati-i-Shtatorit-2019.pdf>

DEKLARATË E MOHIMIT TË PËRGJEGJËSISË:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim në kuadër të projektit “Cilësi, Llogaridhënie, Integritet dhe Transparencë në Arsimin e Lartë – QAINT”. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

WITH FUNDING FROM
 AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministërstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologji
Ministry of Education, Science and Technology

